

Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosova

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

Duke u bazuar në nenin 11 (paragrafi 1.1), nenin 5 (paragrafi 1.5) dhe nenin 18 (paragrafi 10 dhe 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit si dhe nenin 24 (paragrafi 11 dhe 12) të Rregullores së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 20.05.2016, nxjerr këtë:

V E N D I M

I. Mbyllet rasti me nr. AKK – 03-02-4240/15, për z. Aleksandar Spiric – Nënkryetar i Komunës së Mitrovicës Veriore, për shkak se ai ka shmangur gjendjen e konfliktit të interesit në të cilën ndodhej.

II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

A r s y e t i m

I. Rasti i hapur nën dyshimin e bazuar për konflikt interesi në ushtrimin e funksionit publik, nr. AKK – 03-02-4240/15, për z. Aleksandar Spiric – Nënkryetar i Komunës së Mitrovicës Veriore, dhe njëkohësisht pronar në biznesin privat “Video Production Dankos”, është trajtuar sipas procedurës së paraparë në Ligjin Nr. 04/L-051 për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik.

z. Spiric në fillim është njoftuar me shkresë zyrtare nga Agjencia kundër Korrupsionit për fillimin e procedurës së shqyrtimit të gjendjes së mundshme të konfliktit të interesit, pas së cilës ai është kontaktuar nga zyrtarët e AKK-së.

Zyrtari i lartë është njoftuar se nuk mund të ushtroj funksione menaxhuese në biznese private, krahas funksionit publik të zyrtarit të lartë si dhe për ndryshimet që duhet të bëj për të shmangur konfliktin e interesit. Ai ka premtuar se brenda afatit do të shmang konfliktin e interesit në ushtrimin e funksionit publik.

Ndërkohë zyrtari i lartë z. Spiric ka dërguar në Agjenci informatat zyrtare, të lëshuara nga Agjencia për Regjistrimin e Bizneseve në Kosovë, me të cilat vërtetohet se ai ka mbyllur biznesin privat. Me këtë zyrtari i lartë ka shmangur situatën e konfliktit të interesit në të cilin ndodhej.

Andaj u vendos si në dispozitivin e këtij vendimi.

II. Në pajtim me nenin 18 (paragrafi 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.


Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtarit të lartë publik;
- Drejtorit të DPK- së;
- Z./znj. (zyrtarit përgjegjës).

Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit

Hasan Pretëni





Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosova

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

Uskladu sa članom 11.(stav1.1), članom 5(stav 1.5), i članom 18(stav10 i 11) Zakona br.03/L-159 za Agenciju protiv Korupcije, kao i sa članom 24(stav11 i 12) Pravilnika o Radu Agencije protiv Korupcije, Direktor Agencije protiv Korupcije je 20.05.2016 doneo

O D L U K U

I. Zatvara se slučaj broj . AKK – 03-02-4240/15 za g.Aleksandar Spirić- Podpredsednik Opštine Severna Mitrovica, , zato što je visoki javni zvaničnik izbegao sukob interesa u kojem se nalazio.

II. Slučaj se može obnoviti u svako doba ukoliko se pojavljuju nove okolnosti

O b r a z l o ž e n j e

I. Pokrenuti slučaj pod osnovanom sumnjom za Sukob Interesa u Vršnju Javne Funkcije, br AKK – 03-02-4240/15, za g.Aleksandra Spirića- Podpredsednika Opštine Severna Mitrovica, i istovremeno vlasnika privatnog biznisa Video Production “Dankos”, tretiran je prema predviđenoj proceduri po Zakonu br.04/L-051 za Sprečavanje Sukoba Interesa u Toku Vršnja Javne Funkcije.

g. Spirić je prvo, službenim pismom od Agencije protiv Korupcije obavešten o pokretanju procedure razmatranja mogućeg stanja sukoba interesa, nakon čega je kontaktiran od strane službenika APK.

Visoki zvaničnik je obavešten da ne može obavljati funkciju menadžera u privatnom biznisu, uporedo sa funkcijom visokog javnog zvaničnika i za izmene koje treba izvršiti radi izbegavanja sukoba interesa. On je obećao da će u roku izbegnuti sukob interesa u vršenju javne funkcije.

U međuvremenu je g.Spirić dostavio službeno obaveštenje izdato od Agencije za Registraciju Biznisa na Kosovu, kojim se potvrđuje da je on zatvorio privatni biznis. Ovim je visoki zvaničnik izbegao sukob interesa na kojem se nalazio.

Stoga je odlučeno kao u dispozitivu ovog rešenja .

II. Uskladu sa članom 18(stav11) Zakona br.03/L-159 za Agenciju protiv Korupcije, Agencija može u svako doba obnoviti slučaj kada se pojavljuju nove okolnosti, pa je odlučeno kao u dispozitivu ovog rešenja .

Odluka se dostavlja:

- visokom javnom zvaničniku
- direktoru DSK
- odgovornom službeniku

Direktor Agencije protiv Korupcije:

Hasan Preteni

